



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**Nr. i Dokumentit: 22.23.1-2018-08**

**RAPORTI AUDITIMIT PËR KOMUNËN E SKENDERAJT  
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

**Prishtinë, maj 2019**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të komunës së Skenderajt, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Ajtene Llapashtica udhëheqës ekipi, *Lindita Ajeti* dhe *Fisnik Rudaj* anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Faruk Rrahmani*.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	9
4 Qeverisja e mirë.....	28
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	31
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	38
Shtojca II: Letër Konfirmimi .....	41

## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Komunës së Skënderajt për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 15/01/2019.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

### Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

#### **Theksimi i Çështjes**

Si theksim të çështjes, ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se informatat e shpalosura në Pasqyrat Financiare Vjetore në lidhje me pasuritë nuk janë të plota dhe të sakta.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore:**

Pasqyrat financiare -Theksimi i çështjes pasqyron dobësitë në kontrolle për të konfirmuar shpalosjet në pasqyrat financiare të pasurive financiare dhe jo financiare.



Kryetari duhet të sigurohet se procesi i përgatitjes së pasqyrave financiare për vitin 2019 përfshinë një rishikim përfundimtar të menaxhmentit, deklarata për PFV-të të nënshkruhet vetëm pasi të jenë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme (shih kapitullin 2.1).

Edhe pse kontrollet e brendshme kanë operuar në disa fusha, dobësi evidente janë vërejtur në disa sisteme të rëndësishme financiare, duke përfshirë, shpenzimet, pasuritë, llogaritë e arkëtueshme dhe obligimet.



Kryetari duhet ta aplikojë një vlerësim të detajuar të fushave të theksuara në këtë raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe veprime të nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet në kapitullin 3).

Rekomandimet e vitit paraprak nuk po adresohen ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës.



Kryetari duhet ta zbatoj një proces rigoroz për të siguruar që procesi i zbatimit të rekomandimeve të vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive (shih kapitullin 5).

Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial kanë shënuar progres, por jo të mjaftueshëm.



Kryetari duhet të sigurojë që aranzhimet e Qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate në përmirësimin e aranzhimeve të llogaridhënies dhe raportimit menaxherial (shih kapitullin 4).

**Përgjigja e Kryetarit të Komunës**

Kryetari është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

---

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Skenderajit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

#### Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

#### Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se regjistri i pasurive mbi 1,000€ nuk ishte i plotë, pasi që gjashtë pagesa të kryera nga Investimet kapitale me vlerë prej 325,952€ nuk ishin përfshirë në regjistrin e SIMFK-së duke e nënvlerësuar për këtë vlerë pasurinë e prezantuar në PFV-të e Komunës. Këto pagesa kishin të bënin me projektet si: "Hartimi i projekteve"; "Asfaltimi i rrugës Likovc"; "Renovimi i objektit shëndetësor QKMF" dhe "Mirëmbajtja e rrugëve Verore". Vlen të theksohet se pas përfundimit të punës në terren (mars 2019) pasuritë ishin regjistruar në SIMFK, por që në PFV-të e vitit 2018 gjendja kishte mbetur e njëjtë.

---

### **Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV**

Kryetari i Komunës së Skenderajit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik-Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## **2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim**

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;



- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Planin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara publike;
- Raportimin e obligimeve të papaguara;
- Raportet e progresit për projektet kapitale; dhe
- Pyetësin e vet-vlerësimit.

PFV-të janë përgatitur në pajtueshmëri me formatin për raportim, si dhe janë nënshkruar dhe dorëzuar brenda afatit ligjor në MF. Komuna ka korrigjuar PFV-të brenda afatit mirëpo shpалosjet për pasurinë kapitale, mbeten jo të plota.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjen e sipër përmendur jepet rekomandimi:

**Rekomandimi B1** Kryetari, duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet, për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit. Kjo kërkon veprime konkrete për të siguruar në vazhdimësi menaxhimin dhe regjistrimin e plotë të pasurisë në SIMFK përfshirë edhe shpалosjen e drejtë të tyre në PFV.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, llogaritë e arkëtueshme, pasuritë dhe detyrimet.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Skenderajt kishte shpenzuar 96% të buxhetit final për vitin 2018 që nënkupton një realizim të mirë në nivel të përgjithshëm. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive, megjithatë nevojiten mekanizma shtesë për të reaguar në arkëtimin e tyre dhe mbledhjen e të arkëtueshmeve në masë më të madhe.

Gjithashtu, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar: keqklasifikimin e shpenzimeve, angazhimin me marrëveshje të veçanta jashtë procedurave, anashkalimin e rregullave të prokurimit, ekzekutimin e pagesave në mënyrë jo të

rregullt, rritjen e pagesave me vendime gjyqësore dhe vonesave për përfundimin e projekteve kapitale.

Me tutje, komuna duhet të ndër marrë veprime për të përmirësuar menaxhimin dhe raportimin e plotë të pasurisë dhe obligimeve, çështje këto të ngritura edhe në raportin e vitit paraprak.

### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Në i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>12,889,268</b>	<b>13,566,233</b>	<b>13,033,451</b>	<b>12,065,482</b>	<b>11,640,027</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	11,871,959	11,918,017	11,832,370	10,575,442	10,539,790
Huamarrja	83,354	132,390	51,670	-	-
Të bartura nga viti paraprak <sup>2</sup>	-	170,034	138,213	168,199	276,513
Të hyrat vetjake <sup>3</sup>	933,955	1,199,955	900,975	1,320,642	816,824
Donacionet e brendshme	-	7,501	-	-	6,900
Donacionet e jashtme	-	138,336	110,223	1,199	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 679,965€. Kjo rritje ishte rezultat i donacioneve të brendshme dhe të jashtme në vlerë prej 145,837€, të hyrave të bartura nga viti paraprak 170,034€ dhe rritjes së buxhetit për 361,094€ me vendime të Qeverisë.

Në vitin 2018, komuna ka shpenzuar 96% të buxhetit final, me një rënie prej 2% krahasuar me vitin 2017. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>2</sup> Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>3</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetanake.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>12,889,268</b>	<b>13,566,233</b>	<b>13,033,451</b>	<b>12,065,482</b>	<b>11,640,027</b>
Pagat dhe Mëditjet	7,672,685	7,516,479	7,490,289	7,267,204	7,322,830
Mallrat dhe Shërbimet	1,279,785	1,446,371	1,374,212	1,042,725	964,549
Shërbimet komunale	200,440	201,067	197,121	187,782	233,088
Subvencionet dhe Transferet	180,642	361,532	349,047	197,944	252,965
Investimet Kapitale	3,555,716	4,040,784	3,622,782	3,369,827	2,866,595

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte reduktuar për 156,206€. Me vendim të qeverisë buxheti ishte reduktuar për 157,396€, përderisa një rritje kishte ndodhur nga të hyrat vetjake për 1,190€;
- Te mallrat dhe shërbimet, buxheti ishte rritur për 166,585€. Rritja ka ndodhur nga të hyrat vetjake për 150,945€, grantet e donatorëve 2,225€ dhe nga huamarrjet 13,415€. Përderisa buxheti për shërbimet komunale ishte rritur për 627€ nga të hyrat vetjake;
- Buxheti për subvencione ishte rritur për 180,890€. Rritja ka ndodhur me vendim të qeverisë nr.04/74 për 130,000€ dhe 50,890€ nga të hyrat vetjake; dhe
- Buxheti për investimet kapitale ishte rritur për 485,068€. Rritja kishte ndodhur nga të hyrat vetjake për 232,381€, me vendim të qeverisë nr.11/79 për 73,454€, të hyrat nga grantet 143,610 dhe nga huamarrjet 35,622€.

Nga analizat buxhetore vërehet se rritja më e madhe e buxhetit ishte ndikuar nga realizimi i të hyrave vetanake prej 266,000€ dhe të hyrave të bartura prej 170,034€.

---

## Çështja B2<sup>4</sup> - Keq klasifikimi i shpenzimeve

### Gjetja

Ligji Nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 dhe plani kontabël definojnë qartë se shpenzimet duhet të ndodhin nga kategoritë adekuate ekonomike. Ne kemi identifikuar se Komuna ka bërë pagesa nga kategoritë ekonomike jo adekuate si :

- Shpenzimet Kapitale në vlerë prej 16,929€ për projektin “Kanalizimi Fekal te Fabrika për përpunimin e mishit në Polac” ishin paguar gabimisht nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Ky projekt nuk ishte i përfshirë në ligjin e buxhetit 2018 dhe për realizimin e këtij projekti nuk ishte zhvilluar procedura tenderues por ishin shfrytëzuar dy kontrata tjera publike kornizë<sup>5</sup> në bazë të të cilave ishin kryer pagesat;
- Shpenzimet për Subvencione dhe Transfere në vlerë prej 25,419€ që kishin të bënin me kontratën “Furnizim me material ndërtimor për familjet e pastrehë”; dhe 5,500€ për “Ngritja e përkujdesit për shërbime sociale dhe shëndetësore në shtëpi dhe ambulante” ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht nga kategoria e Investime Kapitale; dhe
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime në vlerë prej 8,089€ të cilat kishin të bënin me kontratën “Furnizim me material elektrik, vegla pune për shkolla dhe komunë Skenderaj” ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale.

Shkaku i keq klasifikimit të pagesave (pagesat nga investimet kapitale) ishin rezultat i keq buxhetimit të këtyre projekteve, përderisa keq klasifikimet e shpenzimeve nga mallrat dhe shërbimet janë si pasojë që projekti sipas zyrtarëve ka qenë një investim emergjent nga se ndërtimi i fabrikës së mishit ishte donacion dhe është dashtë t’i ofrohet infrastruktura mbështetëse.

### Rreziku

Planifikimi jo i duhur i ndarjeve të mjeteve buxhetore, ka ndikuar në keq klasifikimin e shpenzimeve. Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktivitetëve financiare të komunës, si dhe në mos realizimin e të gjitha projekteve kapitale të synuara për arritjen e objektivave të komunës.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurohet që planifikimet për shpenzime të bëhen konform kodeve ekonomike të ndara për kategori përkatëse varësisht përfitimeve.

---

<sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

### 3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna për vitin 2018 ishin në vlerë prej 1,719,111€. Prej tyre donacionet ishin me vlerë 143,608€.

Të hyrat e arkëtuara nga institucionet tjera në emër të komunës ishin, nga gjobat në trafik 93,180€; gjobat nga gjykatat 15,200€ dhe gjobat nga agjencia pyjore 761€. Të hyrat kanë të bëjnë kryesisht me arkëtime nga të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	933,955	1,199,955	1,719,111 <sup>6</sup>	1,413,200	994,851
<b>Totali</b>	<b>933,955</b>	<b>1,199,955</b>	<b>1,719,111</b>	<b>1,413,200</b>	<b>994,851</b>

Buxheti final i të hyrave është rritur për 266,0007€ në krahasim me buxhetin fillestar bazuar në vendimet për ngritjen e planit të të hyrave për vitin 2018, shkaku i tejkalimit të arkëtimeve të të hyrave të planifikuara për 43%. Kjo rritje në realizim ka ardhë si rezultat i arkëtimit të të hyrave nga koncesioni në vlerë prej 774,165€.

<sup>5</sup> Nga kontrata "Furnizim me material elektrik, vegla pune për shkolla dhe Komunën e Skenderajt" janë paguar furnizime në vlerë prej 16,929€ dhe nga kontrata "Shërbimet dhe mirëmbajtja teknike e institucioneve komunale dhe arsimore në Komunën e Skenderajt", janë paguar shërbime në vlerë prej 16,013€.

<sup>6</sup> Nuk përfshihen të hyrat e arkëtuara nga institucionet tjera në emër të komunës.

<sup>7</sup> 78,000€ vendimi datë 08.10.2018; 108,000€ vendimi datë 26.10.2018 dhe 80,000€ vendimi datë 26.11.2018

---

## Çështja A1 - Vonesat në lëshimin e lejeve ndërtimore

**Gjetja** Sipas nenit (17) të Ligjit për Ndërtim 04L-110, leja ndërtimore lëshohet nga organi kompetent brenda dyzet e pesë (45) ditë për kategoritë II dhe III. Po ashtu, neni (32) i UA- MMPH nr. 06/2017 parasheh si pjesë përbërëse të këtij udhëzimi edhe shtojcat standarde për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave, lejeve ndërtimore.

Nga tri raste të testuara për lëshimin e lejeve ndërtimore kemi vërejtur se në dy prej tyre kishte vonesa përtej afatit të lejuar, konkretisht vonesat ishin për 46 ditë dhe 18 ditë. Gjithashtu nuk ishin përdorur shtojcat standarde për konfirmimin e pranimit të lejes ndërtimore (shtojca 5) dhe shqyrtimin e kërkesës (shtojca 8) dhe në dosje nuk kishte dëshmi për njoftimin për kompletim të kërkesave.

Si shkak i këtyre vonesave për lëshimin e lejeve ndërtimore sipas zyrtarëve ishin kërkesat e pakompletuara, megjithatë komuna nuk kishte dëshmi për të vërtetuar të njëjtën, pasi nuk kishte aplikuar shtojcat e udhëzimit. Mos përdorimi i shtojcave ishte shkaktuar ngase zyrtarët nuk ishin azhur me kërkesat e reja.

**Rreziku** Mos aplikimi i afateve kohore dhe shtojcave në bazë të ligjit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimore ka shkaktuar konfuzitet në shqyrtimin e tyre, njëherit për ndikim ka pas vonesat në lëshimin e lejeve ndërtimore, të cilat paraqesin jo pajtueshmëri me bazën ligjore.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të sigurojë që zyrtarët përgjegjës aplikojnë shtojcat e parapara me udhëzimin që e rregullon çështjen e lejeve ndërtimore, me qëllim që kur kërkesat për leje janë të pakompletuara, aplikuesit të njoftohen me kohë me qëllim të evitimit të vonesave në dhënien e përgjigjes për leje ndërtimore nga ana e Komunës.

### 3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për pagat dhe mëditjet ishte 7,516,479€ përderisa shpenzimet ishin 7,490,289€. Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe Ministria e Financave (MF).

### Çështja B3 - Mangësitë e marrëveshjeve për shërbime të veçanta

**Gjetja** Neni 12 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil përcakton se emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj duhet të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” (MSHV) për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Komuna gjatë vitit 2018 kishte të angazhuar 19 punonjës me MSHV.

Në dy raste kemi vërejtur se angazhimi ishte bërë pa procedura të thjeshtësuar të rekrutimit, kurse në dy të tjera kemi tejkallim të afatit të angazhimit për tre muaj. Arsyeja pse janë lidhur këto kontrata ishte mungesa e planifikimit buxhetor për këto pozita, dhe mundësia më e lehtë e angazhimit përkundër faktit se këto shërbime ishin kryesisht për pozita të rregullta<sup>8</sup>.

**Rreziku** Angazhimi i stafit për shërbime të veçanta pa procedura të thjeshtësuar të rekrutimit kufizon konkurrencën dhe si pasojë mund të pranohet staf me kompetencë të ulët që ka ndikim që cilësia e shërbimeve të pranuar të mos jenë në përputhje me nevojat.

**Rekomandimi B3** Kryetari, duhet të siguroj se marrëveshjet për shërbime të veçanta janë për punë specifike dhe për to zhvillohet një procedurë e thjeshtuar e rekrutimit dhe kontratat nuk zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjor. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që nevojat për pozitat të rregullta të adresohen në MF gjatë planifikimit buxhetor me qëllim që këto të mos mbulohen me MSHV.

### 3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për këto kategori në vitin 2018 ishte 1,647,437€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,571,333€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet komunale, shpenzimet e derivateve dhe lëndët tjera për ngrohje, mirëmbajtje të objekteve, shpenzime kontraktuese tjera, etj.

<sup>8</sup> MSHV ishin lidhur për pozitat: Asistent administrative, Zyrtar ligjor, Zyrtar për çështje juridike etj.

**Çështja B4 – Dobësi në procesin e tenderimit**

**Gjetja** Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik (UOPP) për kontratat kornizë në nenin 56 pikën 10 dhe 11 thekson se në rastet kur nuk dihen sasitë indikative, atëherë Autoriteti Kontraktues (AK) duhet të përdorë kontratën me çmime për njësi duke e përcaktuar peshën në bazë të rëndësisë së artikujve-shërbimeve, me qëllimin që të marrë ofertën me çmimin më të lirë.

Në dosjen e tenderit për kontratën kornizë “Furnizimi dhe servisimi i aparateve kundër zjarrit në shërbimin e zjarrfikëseve dhe institucioneve komunale në Skenderaj”, kemi identifikuar se nuk ishin përcaktuar sasitë indikative dhe ishte përdorur kontrata me çmime për njësi pa u bërë peshimi i rëndësisë së artikujve/shërbimeve. Në rastin tonë ka qenë vetëm një ofertë dhe nuk kishte ndonjë efekt direkt por kemi të bëjmë me shmangie nga procedurat e prokurimit.

**Rreziku** Shmangia apo mospërfillja e procedurave të prokurimit gjatë përzgjedhjes së ofertave rrezikon që të mos përzgjidhet oferta më e mirë për komunën, njëherit mund të shfaqen probleme edhe të realizimi i kontratave.

**Rekomandimi B4** Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë gjatë procedurave të prokurimit për të siguruar se ato zhvillohen komfor kërkesave ligjore dhe ofrojnë vlerë të shtuar për parane e shpenzuar. Për më tepër, si në rastin e cekur, kriteret mbi përcaktimin e çmimeve sipas rëndësisë së artikujve duhet të jenë vendosur në mënyrë që të ketë bazë përcaktuese në përzgjedhjen e operatorit ekonomik (OE).



**Çështja A2 Shpërblimi me kontratë pa u përmbushur kriteret**

**Gjetja** Në dosjen dhe njoftimin për kontratën kornizë "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve për K.K, DKA, QKMF dhe QPS në Komunën e Skenderajt" AK ka vendosur kriteret që duhet plotësuar për të mundësuar shpërblimin me kontratë.

Ne identifikuam se nga kriteret e kërkuara OE fitues i mungonte çertifikata e TVSH-së, kopjet e kontratave të marrëdhënies së punës për dy mekanikë dhe deklarata me shkrim e OE për vend ndodhjen e objektit të servisimit. Përkundër tyre komisioni i vlerësimit i ka anashkaluar këto kritere dhe e ka rekomanduar menaxherin e prokurimit që OE t'i jepet kontrata.

**Rreziku** Mospërfillja e kriterëve të vendosura gjatë përzgjedhjes së ofertave rrezikon që të përzgjidhet oferta më e mirë për komunën, njëherit mund të shfaqen probleme edhe te realizimi i kontratave/ekzekutimi i pagesave.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të forcojë kontrollin në departamentin e prokurimit, duke siguruar që zyrtari përgjegjës i prokurimit vetëm pas plotësimit të kriterëve, të shpërblej me kontratë OE. Po ashtu, përzgjedhja e komisioneve të vlerësimit duhet të jetë sa më profesionale me qëllim që vlerësimi i tenderëve të bëhet në harmoni të plotë me kriteret dhe dëshmitë e kërkuara në dosje të tenderit.

---

## Çështja B5 – Tejkalmi i pagesave nga kontratat

**Gjetja** Neni 22 i LPP-së<sup>9</sup> përcakton se vlera e kontratave publike kornizë nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus 30% e vlerës totale indikative të saj.

- Për kontratën publike kornizë “Mirëmbajta dhe vendosja e kamerave në shkolla dhe në Komunë të Skenderajt”, ka tejkalm për 19,492€. Vlera e parashikuar e kontratës për tri vite ishte 20,000€, përderisa vlera e pagesave/urdherblerjeve në këto tri vite është 45,492€; dhe
- Për kontratën publike një vjeçare për “Furnizim me thëngjill të terun për të gjitha shkollat, shërbimin e zjarrfikësve dhe shtëpinë e kulturës për Komunën e Skenderajt” tejkalmi mbi vlerën e lejuar ishte për 15,853€. Vlera e kontratës ishte 70,620€, përderisa vlera e pagesave /urdherblerjeve në këtë periudhë ishte 86,473€.

Këto tejkalime kanë ndodhur si shkak i kontrolleve jo efektive dhe komunikimit të dobët mes njërive kërkuese, menaxherit të projektit dhe drejtorisë për ekonomi, financa dhe zhvillim.

**Rreziku** Tejkalmi i vlerës së lejuar përtej kontratës, përveç anashkalimit të rregullave të prokurimit ndikon edhe në absorbimin e fondeve të destinuara për qëllime tjera dhe mund të rezultojë edhe me mungesë të buxhetit për realizimin e projekteve apo shërbimeve të tjera të parapara me plan.

**Rekomandimi B5** Kryetari duhet të forcojë kontrollet për të siguruar se para përgatitjes së projekteve bëhen analiza të mjaftueshme lidhur me nevojat për furnizimet/punët e kontraktuara. Në këtë mënyrë do të përmirësohet menaxhimi i kontratave dhe do të shmangen rastet e tejkalimit mbi normën e lejuar +/-30%.

---

<sup>9</sup> Ligji i Prokurimit Publik nr. 04/L-042 me plotësime dhe ndryshime të ligjeve nr.04/L-237; nr. 05/L-068 dhe 05/L-092

---

### Çështja A3 - Mangësi në menaxhimin e kontratave

**Gjetja** UOPP në nenin 61 & 62 i rregullon çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratave dhe ndarjen e detyrave. Gjatë auditimit kemi identifikuar si në vijim:

- Në tri raste/pagesa janë vërejtur se mungojnë raportet e menaxherëve të kontratës apo të komisioneve për pranimin e mallrave si te pagesa për “Furnizim me mallra dhe shërbime për nevojën e DKRS në vlerë prej 4,198€, te pagesa për “Furnizim me material zyrtar” në vlerë prej 544€; dhe te pagesa për “Furnizim me gjëra ushqimore, pije dhe material higjenik-sanitar” në vlerë prej 1,938€; dhe
- Në pagesën me vlerë prej 8,560€, për kontratën “Furnizim me kartela shëndetësore dhe kasete për vendosjen e kartelave shëndetësore për QKMF-në Skenderaj” kemi identifikuar që komisioni që ka bërë vlerësimin e tenderit ka bërë edhe pranimin e furnizimeve me kartela, që është në kundërshtim me parimet e ndarjes së detyrave.

Shkaku për gjendjen aktuale është se për rastet e furnizimeve rutinë dhe të shpeshta, komuna nuk ka praktikuar pranimet nga ana e komisioneve apo menaxherëve të kontratës, përderisa rasti i dytë si shkak ka mos informimin e duhur të zyrtarëve për kërkesat ligjore.

**Rreziku** Mungesa e raporteve nga komisionet përkatëse, rritë rrezikun e pagesave të pa rregullta dhe monitorimin e dobët të kontratës. Ndarja jo adekuate e detyrave rritë rrezikun e kualitetit dhe përmbushjen/realizimin e kontratës.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të siguroj që me rastin e furnizimeve, pranimi i tyre të bëhet nga menaxherët/komisionet përkatëse dhe të sigurohet që ndarja e detyrave dhe përgjegjësi në aktivitetet e prokurimit të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore, në mënyrë që të shmangët mundësia e konfliktit të interesit.

#### 3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 361,532€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 349,047€. Subvencionet ndahen për entitete publike dhe jopublike dhe kryesisht janë shpenzuar për të përkrahur sektorin e bujqësisë, kulturës, sportit dhe aktivitete tjera në kuadër të Komunës.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

### 3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,040,784€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 3,622,782€. Investimet kanë të bëjnë kryesisht me rregullim të infrastrukturës, ndërtim të shkollave, shpronësime, pajisje dhe përmirësime të ndryshme të kapitalit.

---

#### Çështja A4 - Mangësi në zhvillimin e procedurës së negociuar pa publikim

**Gjetja** Sipas nenit (35.3) të LPP-së, ekzekutimi i një procedure të negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës në asnjë mënyrë nuk e liron AK nga detyrimi i tij që të luajë një rol aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratës, veçanërisht sa ka të bëjë me çmimet, afatet e pranimit, sasi të, karakteristikat teknike dhe garancionet.

Komuna kishte lidhur kontratë për "Punët e paparapara për ndërtimin e Palestrës Sportive në Skenderaj" me procedurë të negociuar pa publikim në vlerë prej 39,846€. Pozicionet e kontraktuara nuk kishin qenë në kontratën fillestare dhe AK (komisioni i vlerësimit) nuk kishte lënë asnjë gjurmë/dëshmi se kishte luajtur rol në negocimin e kushteve të kontratës e në veçanti çmimeve të pozicioneve të kontraktuara nëse ato ishin edhe çmimet reale të tregut.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së kompetencës së komisionit vlerësues dhe të zyrtarit të prokurimit.

**Rreziku** Në procedurat e tilla, mungesa e negocimit të kushteve të kontratës rritë rrezikun që çmimet e ofertuara janë të larta/mbi vlerën e tregut, dhe si pasojë kostoja e kontratës është e lartë dhe AK nuk do ta marrë vlerën për parën e shpenzuar.

**Rekomandimi A4** Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherit të prokurimit që gjatë aplikimit të procedurave të negociuara të mbajnë evidenca të negociatave dhe të kujdesen maksimalisht që kostoja e kontratave me këtë procedurë të jetë kosto sa më e ulët për AK ashtu siç e parasheh baza ligjore. Ndjekja e trajnimeve dhe marrja e sqarimeve nga institucionet kompetente të prokurimit do të mund të rriste kompetencën.

---

## Çështja B6 – Vonesë në realizimin e projektit kapital

**Gjetja** Kontrata për “Ndërtimin e rrethojës në QKMF” në vlerë prej 69,700€, e datës 08.08.2016 është paraparë të përfundojë për 90 ditë pune. Gjatë testimit të pagesës për këtë projekt në vitin 2018, ne kemi vërejtur vonesa në realizimin e këtij projekti pasi sipas ditarit punët kanë përfunduar më datë 09.11.2017, me një vonesë prej 229 ditë.

Shkaku për vonesë kanë qenë pengesat e dala gjatë ekzekutimit të punëve në teren, mbetjet/themelet e objektit të vjetër, megjithëse për këtë kishte projekt ekzekutiv.

**Rreziku** Mos identifikimi i pengesave me kohë, ka ndikuar në vonesat në realizimin e projektit kapital sipas planit dinamik. Këto vonesa ndikojnë në mos arritjen e objektivave në realizimin e projekteve kapitale.

**Rekomandimi B6** Kryetari, duhet të sigurojë një shqyrtim detal të arsyeve që kanë shkaktuar vonesat në realizimin e projekteve dhe të ndërmerri masat e nevojshme në mënyrë që ato të përfundohen brenda afateve të arsyeshme kohore duke shmangur bartjen e tyre në periudhat e ardhshme.

### 3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

---

**Çështja A5 - Pagesat e ekzekutuara nga ana e Thesarit për vendimet Gjyqësore**

**Gjetja** Neni 39 i LMFPF përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda 30 ditëve kalendrike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Ne kemi identifikuar se Thesari kishte ekzekutuar në bazë të vendimeve gjyqësore pagesa në vlerë prej 406,025€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 378,130€ dhe shpenzime procedurale të gjykatës (përmbartimit) ishin 27,895€. Po ashtu, kjo formë e pagesave nga thesari ka ndikuar në marrjen e mjeteve nga kategorive ekonomike jo adekuate. Keqklasifikimi nga këto pagesa ishte në vlerë prej 62,475€.

Pagesat kryesisht kishin të bëjnë me pagesat e dala nga marrëveshja kolektive për pagesë të tri pagave jubilarë të punonjësve të arsimit dhe tri paga përcjellëse me rastin e pensionimit, si dhe vonesat në pagesa për OE, si shkak i mungesës së mjeteve buxhetore.

**Rreziku** Situata e krijuar që pagesat të ekzekutohen direkt nga ana e Thesarit përmes procedurave të përmbartimit ndikon direkt në rritjen e kostos për Komunën dhe shpeshherë edhe në keqklasifikimin e shpenzimeve.

**Rekomandimi A5** Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim me MF ashtu që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Gjithashtu obligimet të paguhen brenda afateve kohore të parapara ligjore sipas LMFPF.

## Çështja C1 – Dobësi në procedurat e prokurimit

**Gjetja** Neni 25 i LPP-së nr. 05/L-068, obligon AK që me rastin e nënshkrimit të kontratës, brenda dy ditëve ta përgatisë njoftimin për nënshkrimin e kontratës. Rregulla Financiare 01/2013/MF, obligon organizatën buxhetore që urdhër blerjet duhet t'i paraprijnë pranimit të faturës dhe mallit. Si rezultat i testeve tona, kemi identifikuar se:

- Nga 42 raste të testuara të pagesave, prej tyre 14 pagesa të mallrave e shërbimeve dhe nëntë pagesa të Investimeve kapitale kanë rezultuar me urdhër blerje të proceduara pas pranimit të mallit dhe faturës; dhe
- Në shtatë procedura të prokurimit të mallrave e shërbimeve dhe gjashtë të investimeve kapitale, mungonte njoftimi për nënshkrimin e kontratës.

Arsyet e anashkalimit të këtyre rregullave ndërlidhen me faktin që këto mangësi nuk e kanë ndikuar mbarëvajtjen e procesin dhe janë neglizhuar.

**Rreziku** Anashkalimi i rregullave të prokurimit dhe pranimi i faturës/mallrave para procesimit të urdhër blerjes rrit rrezikun që informatat të mos jenë transparente dhe të pranohen punët apo mallrat e shërbimet jashtë kërkesave të parapara, si në sasi ashtu edhe në cilësi.

**Rekomandimi C1** Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit procedimin e njoftimit për nënshkrim të kontratës dhe se kontrollet në ekzekutimin e pagesave janë duke u respektuar në vazhdimësi për tu siguruar që malli-puna/fatura nuk duhet pranuar para se të jetë procesuar urdhër blerja.

## 3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurisë kapitale e paraqitur në PFV-të 2018 ishte 152,846,000€ ndërsa vlera e pasurisë jo kapitale ishte 649,000€. Stoqet në fund vit ishin 30,000€<sup>10</sup>.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i mbajtjes së regjistrave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullores MF – Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, procesin e inventarizimit dhe ekzistencën fizike të pasurive dhe kemi identifikuar çështjet si në vijim.

<sup>10</sup> Stoqet e depos në QKMF, pasi komuna nuk ka depo tjetër.

---

## Çështja C2 - Mos funksionimi i plotë i sistemit e-pasuria si dhe mungesa e Depos

### Gjetja

Neni 6.3 i rregullores për menaxhimin e pasurive nr. 02/2013 përcakton se pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin "E-pasuria". Sipas nenit 8.2 - Pranimi i pasurive jo financiare në depo duhet të bëhet në bazë të fletëpranimit përkatës të nënshkruar nga Zyrtari i Pranimit/Logjistikës, pas verifikimit të sasisë, vlerës dhe cilësisë. Ne identifikuam se:

- Për evidentimin dhe raportimin e pasurisë jo kapitale nën 1,000€ dhe stoqeve Komuna nuk bazohet në sistemin e-pasuria pasi nuk është plotësisht funksional, dhe nuk e llogaritet fare zhvlerësimin. Për raportimin e këtyre pasurive në PFV janë përdorë të dhënat të cilat menaxhohen në regjistra të Excel-it, ku ekziston rreziku lidhur me plotësinë dhe saktësinë e tyre pasi që shënimet mund të ndryshohen në çdo kohë dhe pa lënë gjurmë; dhe
- Komuna nuk posedon një depo për pranimin dhe mbajtjen e stoqeve, përveç deposë së QKMF-së që përdoret për pranimin e materialeve shëndetësore.

Shkaku i mos funksionimit të sistemit të E-pasuria ndërlidhet edhe me menaxhimin jo adekuat nga ana e Ministrisë së Administratës Publike, por edhe me kompetencën e personave përgjegjës. Kurse për mungesën e depos nuk ka ndonjë justifikim përveç mungesës së hapësirave.

### Rreziku

Mos funksionalizimi i plotë i sistemit e-pasuria, vështirëson menaxhimin adekuat të pasurisë dhe rrit rrezikun e gabimeve gjatë evidentimit të pasurisë si dhe përlllogaritjes manuale të zhvlerësimit. Kjo ndikon në mungesë të informatave të sakta lidhur me pasurinë që e posedon komuna, dhe në prezantim jo të drejtë dhe të saktë të pasurive në PFV. Mungesa e depos tregon se kontrollet janë joefektive dhe si pasojë nuk kemi menaxhim adekuat të stoqeve.

### Rekomandimi C2

Kryetari, duhet të siguroj funksionalizimin dhe përdorimin e plotë të sistemit E-pasuria për regjistrimin e pasurive nën 1,000€ dhe stoqeve si dhe të funksionalizoj depon për menaxhimin e stoqeve. Po ashtu, duhet siguruar trajnime të zyrtarit të pasurisë për një menaxhim më të mirë të pasurisë.



## Çështja A6 - Parregullsitë e evidentuara gjatë ekzaminimit fizik

### Gjetja

Sipas nenit 6.1 të rregullores MF nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive Jo financiare, çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Nga ekzaminimi fizik identifikua se:

- Gjatë ekzaminimit fizik për “Ndërtimin e shkollës në Makërma”, për faturimin me vlerë 18,855€ që kishte të bënte me vendosjen e dyerve dhe dritareve, kemi evidentuar që ato nuk ishin të gjitha të vendosura, përveç një numri të vogël të kornizave të dritareve;
- Në dy pagesa në vlerë prej 70,540€ për pajisje mjekësore, që kishin të bënin me blerjen e katër monitorëve dhe dy ultrazërave, kemi evidentuar se janë regjistruar në SIMFK si vlerë totale, përderisa gjatë verifikimit fizik kemi vërtetuar se nuk kishin të vendosur bar kodet; dhe
- Gjithashtu mungesa e bar kodeve është vërejtur edhe te pasuritë e blera me vlerë nën 1,000€ të evidentuara gjatë ekzaminimit fizik për:
  - furnizimin me 13 ormanë me vlerë 910€ në QKFM;
  - furnizimi me kamera me vlerë 1,400€ në njësinë e zjarrfikësve; dhe
  - furnizimi me fotokopje me vlerë 995€, edhe pse ju ka vendos bar kodi, i njëjti nuk përputhet me regjistrin në E-pasuria.

Shkaku i mos vendosjes së bar kodeve ka të bëjë me neglizhencën dhe kompetencën e personave përgjegjës, ndërsa te pagesa për pozicionet që nuk ishin vendosur ishte mungesa e përgjegjësisë së menaxherit/organit mbikëqyrës të kontratës.

### Rreziku

Mos vendosja e bar kodeve për tërë pasurinë që posedon komuna vë në rrezik humbjen/tjetërsimin e pasurisë. Ndërsa pagesat për punët e papërfunduara mund të rezultojnë në pagesa të parregullta.

### Rekomandimi A6

Kryetari duhet të sigurojë se personat përgjegjës që menaxhojnë kontratat e komunës janë të përgjegjshëm dhe llogaridhënës dhe pagesat aprovohen nga organi mbikëqyrës vetëm pas pranimit të punëve të përfunduara. Gjithashtu pasurive duhet të ju vendosen barkodet dhe të regjistrohen në SIMFK ndaras e jo si vlerë totale e projektit.

## 3.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme në PFV në fund të vitit ishin 1,197,000€. Strukturën e të arkëtueshmeve e përbëjnë: tatimi në pronë, taksa në biznes, qiratë dhe lejet e ndërtimit. Pjesëmarrjen më të madhe në

---

këtë strukturë e kanë të arkëtueshmet nga tatimi në pronë në vlerë 803,000€ dhe të arkëtueshmet taksa në biznes 246,000€.

---

### Çështja B7 - Rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme

#### Gjetja

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve pasi që vazhdon rritja e tyre nëpër vite. Nga viti paraprak ato janë rritur për rreth 46,000€ e rritjen më të madhe e kanë të arkëtueshmet nga tatimi në pronë. Komuna nuk kishte marrë ndonjë veprim konkret që të arkëtueshmet t'i arkëtoj përmes përmbaruesve si një mundësi për mbledhjen e të arkëtueshmeve. Të gjeturat i prezantojmë si në vijim:

- Vonesa të konsiderueshme në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë, kryesisht nga viti 2003. Prej tyre dy raste kishin të bënte me të arkëtueshmet e AKP-së në vlerë 7,970€ për organizatat shoqërore të përfshira në procesin e privatizimit, si dhe në 15 raste tjera kishte vonesa në pagesa (nga viti 2005) nga qytetarë dhe biznese me vlerë prej 29,649€, përkundër nenit 23 të ligjit Nr. 06L/005<sup>11</sup>, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme;
- Te taksat në biznes edhe pse komuna kishte marrë vendim (2017) për shlyerjen e borxheve për taksa në biznes deri në vitin 2008 për bizneset të cilat i kishin kryer obligimet e tyre për vitet 2009-2014, ky veprim nuk i ka inkurajuar bizneset që ti paguajnë borxhet. Te taksat në biznes 5 nga 6 mostrat e testuara me vlerë 12,804€ ishin borxhe të vjetra nga viti 2004, përkundër rregullores për taksa dhe tarifa ku përcaktohen kriteret e pagesave të tyre;
- Te llogaritë e arkëtueshme të lejeve të ndërtimit 29,452€ vërejtëm se këto llogari kishin të bënin me borxhin nga një leja ndërtimore e datës 10.10.2017, megjithëse nuk është përmbushur kriteri i vendosur në vendim për leje që pagesat të kryhen: kësti i dytë deri me 30.01.2018 dhe kësti i tretë 30.03.2018, përderisa i njëjti posedon lejen; dhe
- Borxhi i akumuluar për dy mostra, shfrytëzues të hapësirës publike/lokal afarist në vlerë prej 7,525€ figuron nga viti 2016, ndërsa për shfrytëzim të pronës publike/toka kemi testuar një mostër me borxh

---

<sup>11</sup> Neni 23 i ligjit Nr. 06L/005, pika (2) 2. specifikon "Për vitin tatimor 2018, kësti i dytë i tatimit në pronën e paluajtshme paguhet deri më 31 dhjetor të atij viti tatimor, sipas Ligjit Nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-100.

të akumuluar 1,280€, përderisa me kushte të kontratës ishin paraparë pagesa mujore.

Komuna nuk ka ndonjë softuer të veçantë për menaxhimin e të hyrave/llogarive të arkëtueshme, përveç taksave në biznes. Të arkëtueshmet e qirasë dhe rentës menaxhohen në Excel, (ku mund të ndryshohen dhe nuk mbesin gjurmë) dhe të dhënat e prezantuara nuk japin siguri të plotë për saktësinë dhe plotësinë e tyre.

**Rreziku**

Mungesa e veprimeve konkrete për arkëtimin e të arkëtueshme sipas kriterëve të parapara, ndikon në rritjen e këtyre llogarive, humbjen financiare si dhe rrezikon mos realizimin e projekteve të komunës nga të hyrat e realizuara. Mungesa e softuerëve/data bazës funksionale ka për rrezik saktësinë dhe plotësinë e informatave për të arkëtueshmet dhe shpalosjen e tyre në PFV.

**Rekomandimi B7** Kryetari duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme dhe procedura të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe arkëtimit të borxheve. Posedimi i një softueri/data baze do ta lehtësonte punën dhe mirëmbajtjen e këtyre llogarive.

### 3.4 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 403,560€ apo afër 66% më të ulëta se vitin paraprak (obligimet e vitit 2017 ishin 1,174,280). Kjo kryesisht ka ardhur si rezultat i ekzekutimit të një numri të lartë të pagesave me vendime gjyqësore, pasi komuna ju ka dhënë përparësi shlyerjes së obligimeve paraprake.

Detyrimet kontingjente të paraqitura në PFV janë në vlerë prej 1,176,000€. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore që mund të ketë Komuna për vitin e ri fiskal.

## Çështja B8 - Vonesat në pagesa si dhe dobësitë në raportimin e obligimeve

### Gjetja

Sipas Rregullës financiare nr. 02/2013/MF për raportimin e obligimeve të papaguara të OB-ve, neni 5 pika 3 thekson se “Raporti mujor i obligimeve të papaguara”, duhet të përfshijë gjendjen e obligimeve të periudhës raportuese, përfshirë këtu të gjitha obligimet, pa marrë parasysh se në cilën periudhë kanë ndodhur”. Po ashtu, OB duhet që çdo faturë të vlefshme për pagesë, ta paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës. Ne kemi vërejtur se:

- Vlera e obligimeve të raportuara për muajin dhjetor në MF ishte 26,519€, kurse vlera e obligimeve në PFV ishte 403,560€. Gjatë analizës së kësaj difference ne identifikuar se raportimet mujore në thesar paraqiten vetëm si obligime të muajit përkatës e jo siç kërkohet me rregullore që edhe obligimet e muajve paraprak që nuk janë paguar duhet të përfshihen në raport. Katër fatura që ne i testuam në vlerë prej 82,937€ nuk ishin të përfshira në raportin e dhjetorit edhe pse do të duhej; dhe
- Nga 19 raste të testuara me vlerë prej 197,094€ kemi identifikuar se ka vonesa në pagesa të faturave nga 6 deri në 120 ditë mbi afatin kohor të përcaktuar për pagesë. Këto fatura nuk janë të paraqitura në raportet mujore përkatëse të obligimeve të papaguara të raportuara në MF.

Shkaku i mos raportimit të obligimeve ka ardhur nga mungesa e informacionit dhe komunikimit të dobët mes zyrtarit raportues të obligimeve dhe drejtorive të tjera në Komunë.

### Rreziku

Kontrollet e dobëta në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve mujore, paraqesin pasqyrim jo të drejtë të obligimeve, ndërsa vonesat në pagesa krijojnë implikime buxhetore për vitin fiskal vijues si dhe mundësinë e ekzekutimeve direkt nga Thesari.

**Rekomandimi B8** Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle në ekzekutimin e pagesave, dhe në rast të paraqitjes së obligimeve të komunës, ato të jenë raportuar në mënyrë të plotë duke përfshirë të gjitha obligimet pa marrë parasysh se në cilën periudhë kanë ndodhur.

## 4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset

ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

## Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Procesi i dobët për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të vitit paraprak, mungesa e proceseve monitoruese për menaxhimin e rrezikut dhe kontrole të dobëta mbi shpenzimet dhe të hyrat janë disa nga dobësitë e identifikuara në qeverisje. Komuna me kohë kishte përmbushë kërkesën për dorëzimin e pyetësorit të vetëvlerësimit në MF. Njëra nga çështjet e pyetësorit e cila kishte të bënte me proceset efektive të monitorimit lidhur me progresin e objektivave, konsiderohet si e vendosur nga ana e komunës mirëpo, nuk na janë ofruar dëshmitë në mbështetje të këtyre konkluzioneve.

Komuna posedon këto plane: Planin Zhvillimor Komunal 2017-2025, Plani Rregullativ Urban, përderisa është në hartim e sipër të Hartës Zonale.

### 4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - drejtori dhe një auditor. Përveç planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe planin vjetor të punës ku ishin përfshirë pesë auditime, prej të cilave katër ishin realizuar.

Komiteti i auditimit ishte funksional dhe kishte mbajtur katër takime të rregullta ku janë shqyrtuar raportet e auditimit të brendshëm duke i dhënë mbështetje NjAB-së me zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga ana e menaxhmentit.

### Çështja C3 - Mos kompletimi i NJAB-së

- Gjetja** Neni (3) i UA 23/2009<sup>12</sup> për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm përcakton që çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi 5 milion€ duhet të ketë së paku tre auditorë. Rekomandimi i vitit të kaluar, për kompletimin e NJAB-së ishte implementuar pjesërisht, pasi Komuna kishte bërë rekrutimin e vetëm një auditori në mungesë të planifikimit buxhetor.
- Rreziku** Mos kompletimi i NJAB me staf të mjaftueshëm, mund të ndikojë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik, dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e veprimeve me kohë për parandalimin e gabimeve të mundshme.
- Rekomandimi C3** Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se Njësia e Auditimit të Brendshëm do të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas UA në fuqi.

## 4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente.

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

<sup>12</sup> Ky UA lidhet me ligjin I cili është shfuqizua, mirëpo edhe rregullorja e cila derivon nga ligji aktual rregullorja (QRK) nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, parasheh që organizata buxhetore me më shumë se 7 mil€ të kenë tre auditorë, kjo rregullore hyn në fuqi nga viti 2019.

---

## Çështja B9 - Dobësi në kontrollet menaxheriale

**Gjetja** Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim jo të mirë financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë, si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Rrjedhimisht pasqyrat financiare vjetore kanë rezultuar me pasaktësi dhe gabime. Trajtimi i disa zërave nuk ka qenë adekuat, si regjistrat e paplota të pasurive, klasifikimi i shpenzimeve në PFV.

**Rreziku** Kërkesat jo të qarta të llogaridhënies dhe raportimit financiar duhet të forcohen për të përkrahur efektivitetin e menaxhimit financiar brenda komunës, në mënyrë që informacioni financiar të jetë i plotë në funksion që ta përkrahë vendimmarrjen e menaxhmentit.

**Rekomandimi B9** Kryetari, duhet të sigurojë vendosjen e proceseve efektive të menaxhimit të rrezikut nëpër sektorët përkatës të organizatës, të siguroj se është përcaktuar forma e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë.

## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të komunës ka rezultuar me 19 rekomandime kryesore. Komuna Skenderaj kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i ZKA-së, bashkë me planin për implementimin e rekomandimeve ishte diskutuar në Asamblenë Komunale në mbledhjen e datës 28/09/2018.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, gjashtë rekomandime janë zbatuar; nëntë rekomandime ishin të përsëritura; tri pjesërisht të përsëritura si dhe një rekomandim ishte i mbyllur. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

---

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	<p>Kryetari, duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për ta konfirmuar menaxhimin dhe regjistrimin e plotë të pasurisë, përfshirë edhe shpalosjen e drejtë të tyre në PFV.</p> <p>Po ashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018, i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme</p>	Nuk janë marrë veprime	Rekomandimi i përsëritur Ref: B1
2	Menaxhimi financiar dhe Kontrollit	Kryetari duhet të sigurohet që planifikimet për shpenzime të bëhen konform kodeve ekonomike të ndara për kategori përkatëse varësisht përfitimeve.	Nuk janë marrë veprime	Rekomandimi i përsëritur Ref: B2
3	Të hyrat	Kryetari, duhet t'i analizojë pengesat në zbatimin e kësaj kërkesë dhe të identifikojë mënyra për adresimin e rekomandimit në këtë fushë. Kryetari duhet të siguroj mekanizma efektiv për verifikimin e kuotës së përcaktuar prej 1/3-tës së pronave për tatimin në pronë siç kërkohet me udhëzimin administrativ.	Komuna kishte arritur të verifikojë pronat-kuotën prej 20% me ligjin e ri	Rekomandimi i zbatuar.
4	Pagat dhe shtesat	Kryetari, duhet të sigurojë proces transparent dhe konkurrues për të gjithë aplikantët duke ndjekur procedurat e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës sipas UA për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, me qëllim të përzgjedhjes së duhur të stafit	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjajshme	Rekomandimi i zbatuar.
5	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari, duhet të siguroj se punonjësit me MShV të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike dhe angazhimet për këto shërbime nuk duhet të zgjasin më shumë se gjashtë muaj. Për të gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se janë marrë në konsideratë me rastin e planifikimit buxhetor,	Nuk janë marrë veprime	Rekomandimi i përsëritur Ref: B3



		të trajtohen si të nevojshme dhe të diskutohen me MF.		
6	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë përgjatë procedurave të prokurimit për të siguruar se ato zhvillohen komfor kërkesave ligjore dhe ofrojnë vlerë të shtuar për paranë e shpenzuar. Për më tepër, si në rastin e cekur, kriteret mbi përcaktimin e çmimeve sipas rëndësisë së artikujve duhet të jenë vendosur, në mënyrë që të ketë bazë përcaktuese për përzgjedhjen e OE.	Nuk janë marrë veprime	Rekomandimi përsëritur Ref: B4
7	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari, duhet të sigurojë se janë analizuar shkaqet e rasteve të identifikuar dhe të sigurojë se njësitë kërkuese paraqesin me kohë kërkesa për llojin dhe nevojën e shërbimeve, po ashtu, të shtohen kontrollet gjatë ekzekutimit të pagesave, në mënyrë që, realizimi i pagesave të bëhet sipas kushteve të përcaktuara. Të gjitha mallrat dhe shërbimet duhet të pranohen sipas kushteve kontraktuale dhe nga komisionet përkatëse.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjajshme	Rekomandimi i zbatuar
8	Subvencionet dhe transferet	Kryetari, duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet në procesin e ndarjes së subvencioneve, dhe se përfituesit i plotësojnë kriteret në bazë të cilave është lejuar subvencioni bazuar në rregullore. Gjithashtu duhet siguruar monitorimi i procesit të subvencionimit, deri sa të arrihet siguria se mbështetja e dhënë ka arritur qëllimin e subvencionimit.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjajshme	Rekomandimi i zbatuar.
9	Investimet kapitale	Kryetari, duhet të sigurojë se kontratat përpilohen në përputhje të plotë me marrëveshjet e bëra me palët e ndërlidhura me qëllim të evitimit të implikimeve financiare që shkaktohen më tej gjatë realizimit të tyre. Kryetari po ashtu duhet të sigurojë zotimin e mjeteve për projekte para lidhjes së kontratave.	Ka qenë rast i izoluar, nuk kemi identifikuar çështje të ngjajshme.	Rekomandimi i zbatuar
10	Investimet kapitale	Kryetari, duhet të sigurojë një shqyrtim detal të arsyeve që kanë shkakuar vonesat në realizimin e këtyre projekteve dhe të ndërmer masat e nevojshme në mënyrë që ato të përfundohen brenda afateve të arsyeshme kohore duke shmangur bartjen e tyre në periudhat e ardhshme.	Nuk janë marrë veprime	Rekomandimi përsëritur Ref: B6
11	Çështjet e përbashkëta	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë në mënyrë që kontratat të nënshkruhen vetëm	Nuk kemi identifikuar	Rekomandimi i zbatuar.

		atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë ekzekutimin e tyre.	çështje të ngjajshme	
12	Çështjet e përbashkëta	Kryetari, duhet të forcojë kontrollet për të siguruar se para përgatitjes së projekteve bëhen analiza të mjaftueshme lidhur me nevojat për furnizimet/punët e kontraktuara. Në këtë mënyrë do të përmirësohet menaxhimi i kontratave dhe do të shmangen rastet e tejkalimit mbi normën e lejuar +/-30%.	Nuk janë marrë veprime	Rekomandimi i përsëritur Ref: B5
13	Çështjet e përbashkëta	Kryetari, duhet të siguroj funksionimin e mekanizmave të kontrollit ku të gjitha faturat evidentohen, protokolohen dhe paguhen brenda afateve të përcaktuara ligjore. Po ashtu, procedimi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPN-në, dhe me rregullat financiare.	E zbatuar-Komuna kishte filluar me protokolimin e faturave.	Rekomandimi pjesërisht i përsëritur Ref: C1
14	Pasuritë	Kryetari, duhet të siguroj që menaxhimi i pasurisë jo financiare të bëhet në përputhje të plotë me Rregulloren 02/2013 për menaxhimin e pasurisë. Në këtë aspekt duhet të sigurojë evidentimin e pasurisë jo kapitale si dhe të sigurojë funksionalizimin e plotë të sistemit e-pasuria për regjistrimin e pasurive nën 1,000€ dhe stoqeve. Me tutje, të sigurojë se pas procesit të inventarizimit gjendja e inventarizuar krahasohet me regjistrin e përgjithshëm të pasurive, në mënyrë që diferencat e mundshme identifikohen dhe më pas pasqyrohen në regjistrat e pasurive	Mangësitë nga Inventarizimi ishin eliminuar.	Rekomandimi pjesërisht i përsëritur Ref: C2
15	Të arktueshmet	Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duhet të sigurojë procedura të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe arkëtimin e tyre. Posedimi i programit efektiv do ta lehtësonte punën dhe mirëmbajtjen e këtyre llogarive.	Nuk janë marrë veprime	Rekomandimi i përsëritur Ref: B7
16	Obligimet	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle në ekzekutimin e pagesave, dhe në rast të paraqitjes së obligimeve të komunës, ato të jenë raportuar në mënyrë të plotë duke përfshirë të gjitha obligimet pa marrë parasysh se në cilën periudhë kanë ndodhur.	Nuk janë marrë veprime	Rekomandimi i përsëritur Ref: B8
17	Procesi i zbatimit të rekomandimeve	Kryetari, duhet të siguroj se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioriteteve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në		Rekomandimi i mbyllur;

		mënyrë sistematike, dhe aty ku ka ngecje, të propozohen masat adekuate.		
18	Auditimi i brendshëm	Kryetari, duhet të rishikoj situatën nëse NjAB ka burime të mjaftueshme njerëzore për të përmbushë në mënyrë të suksesshme detyrat e saj, si dhe të sigurojë që aktiviteti i ardhshëm i NjAB-së të përfshijë më shumë auditime të cilat mbulojnë të gjitha fushat e rëndësishme për komunën.	Një auditor ishte rekrutuar por ende nuk ishte kompletuar NJAB.	Rekomandi m pjesërisht i përsëritur Ref: C3
19	Raportimi menaxherial llogaridhëni a dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari, duhet të sigurojë vendosjen e proceseve efektive të menaxhimit të rrezikut nëpër sektorët përkatës të organizatës, të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme brenda një periudhe të arsyeshme kohore.	Nuk janë marrë veprime	Rekomandi m i përsëritur Ref: B9
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PFV Ref: B1	Kryetari, duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet, për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit. Kjo kërkon veprime konkrete për të siguruar në vazhdimësi menaxhimin dhe regjistrimin e plotë të pasurisë në SIMFK përfshirë edhe shpalsjen e drejtë të tyre në PFV.		
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit Ref: B2	Kryetari duhet të sigurohet që planifikimet për shpenzime të bëhen konform kodeve ekonomike të ndara për kategori përkatëse varësisht përfitimeve.		
3	Të Hyrat Ref: A1	Kryetari duhet të sigurojë që zyrtarët përgjegjës aplikojnë shtojcat e parapara me UA që e rregullojnë çështjen e lejeve ndërtimore, me qëllim që kur kërkesat për leje janë të pakompletuara, aplikuesit të njoftohen me kohë me qëllim të evitimit të vonësave në dhënien e përgjigjes për leje ndërtimore nga ana e Komunës		
4	Pagat dhe Mëditjet Ref: B3	Kryetari, duhet të siguroj se marrëveshjet për shërbime të veçanta janë për punë specifike dhe për to zhvillohet një procedurë e thjeshtuar e rekrutimit dhe kontratat nuk zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjor. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që nevojat për pozitat të rregullta të adresohen në MF gjatë planifikimit buxhetor me qëllim që këto të mos mbuloen me MSHV.		
5	Mallra dhe Shërbime Ref: B4	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë përgjatë procedurave të prokurimit për të siguruar se ato zhvillohen komfor kërkesave ligjore dhe ofrojnë vlerë të shtuar për paratë e shpenzuar. Për më tepër, si në rastin e cekur, kriteret mbi përcaktimin e çmimeve sipas rëndësisë së artikujve duhet të jenë vendosur, në mënyrë që të ketë bazë përcaktuese për përzgjedhjen e OE.		

6	Mallra dhe Shërbime Ref: A2	Kryetari duhet të forcojë kontrollin në departamentin e prokurimit, duke siguruar që zyrtari përgjegjës i prokurimit vetëm pas plotësimit të kriterëve, të shpërblej me kontratë OE. Po ashtu, përzgjedhja e komisioneve të vlerësimit duhet të jetë sa më profesionale me qëllim që vlerësimi tenderëve të bëhet në harmoni të plotë me kriteret dhe dëshmitë e kërkuara në dosje të tenderit.
7	Mallra dhe Shërbime Ref: B5	Kryetari duhet të forcojë kontrollet për të siguruar se para përgatitjes së projekteve bëhen analiza të mjaftueshme lidhur me nevojat për furnizimet/punët e kontraktuara. Në këtë mënyrë do të përmirësohet menaxhimi i kontratave dhe do të shmangen rastet e tejkalimit mbi normën e lejuar +/-30%.
8	Mallra dhe Shërbime Ref: A3	Kryetari duhet të siguroj që me rastin e furnizimeve, pranimi i tyre të bëhet nga menaxherët/komisionet përkatëse dhe të sigurohet që ndarja e detyrave dhe përgjegjësive në aktivitetet e prokurimit të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore, në mënyrë që të shmangët mundësia e konfliktit të interesit.
9	Investimet Kapitale Ref: A4	Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherit të prokurimit që gjatë aplikimit të procedurave të negociuara të mbajnë evidenca të negociatave dhe të kujdesen maksimalisht që kostoja e kontratave me këtë procedurë të jetë kosto sa më e ulët për autoritetin kontraktues ashtu siç e parasheh baza ligjore. Ndjekja e trajnimeve dhe marrja e sqarimeve nga institucionet kompetente të prokurimit do të mund të rriste kompetencën
10	Investimet Kapitale Ref: B6	Kryetari, duhet të sigurojë një shqyrtim detal të arsyeve që kanë shkaktuar vonesat në realizimin e këtyre projekteve dhe të ndërmerr masat e nevojshme në mënyrë që ato të përfundohen brenda afateve të arsyeshme kohore duke shmangur bartjen e tyre në periudhat e ardhshme.
11	Çështjet e përbashkëta M&Sh-IK Ref: A5	Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim me MF ashtu që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Gjithashtu obligimet të paguhen brenda afateve kohore të parapara ligjore sipas LMFPF.
12	Çështjet e përbashkëta M&Sh-IK Ref: C1	Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit procedimin e njoftimit për nënshkrim të kontratës dhe se kontrollet në ekzekutimin e pagesave janë duke u respektuar në vazhdimësi për tu siguruar që malli/fatura nuk duhet pranuar para se të jetë procesuar urdhër blerja.
13	Pasuritë Ref: C2	Kryetari, duhet të siguroj funksionalizimin dhe përdorimin e plotë të sistemit E-pasuria për regjistrimin e pasurive nën 1,000€ dhe stoqeve si dhe të funksionalizoj depon për menaxhimin e stoqeve. Po ashtu, duhet siguruar trajnime të zyrtarit të pasurisë për një menaxhim më të mirë të pasurisë.
14	Pasuritë Ref: A6	Kryetari duhet të sigurojë se personat përgjegjës që menaxhojnë kontratat e komunës janë të përgjegjshëm dhe llogaridhënës dhe pagesat aprovohen nga organi mbikëqyrës vetëm pas pranimi të punëve të përfunduara. Gjithashtu pasurive duhet të ju vendosen barkodet dhe të regjistrohen në SIMFK ndaras e jo si vlerë totale e projektit.
15	Llog. Arkt. Ref. B7	Kryetari duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme dhe procedura të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe

		arkëtimit të borxheve. Posedimi i një softueri/ data baze do ta lehtësonte punën dhe mirëmbajtjen e këtyre llogarive.
16	Obligimet Ref:B8	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle në ekzekutimin e pagesave, dhe në rast të paraqitjes së obligimeve të komunës, ato të jenë raportuar në mënyrë të plotë duke përfshirë të gjitha obligimet pa marrë parasysh se në cilën periudhë kanë ndodhur
17	Sistemi i Auditimit të brendshëm Ref C3	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e këkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se Njësia e Auditimit të Brendshëm do të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas UA në fuqi.
18	Raportimi menaxherial Ref. B9	Kryetari, duhet të sigurojë vendosjen e proceseve efektive të menaxhimit të rrezikut nëpër sektorët përkatës të organizatës, të siguroj se është përcaktuar forma e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.


158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.



## Shtojca II: Letër Konfirmimi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Skenderaj  
Skupština Opštine Skenderaj  
Skenderaj Municipal Assembly

Zyra e Kryetarit /Kabinet Prisednika / Office of the Mayor

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Skenderajt, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Bekim Jashari

Kryetar i Komunës së Skenderajt

Data: 10.Prill.2019, Skenderaj,